

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5782
E martë, 21 maj 2019
çmimi 0.40 €

Maqedonia e Veriut i njeh patentshoferët e Kosovës

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut e ka ratifikuar marrëveshjen me Republikën e Kosovës për njohjen reciproke të lejeve për vozitje bazuar në marrëveshjen e arritur mes dy shteteve më 28 janar 2019 | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



PRESIDENTI: MASAKRA E DUBRAVËS, NDËR AKTET MË TË RËNDA GJENOCIDALE TË SERBISË F. 6

PROTESTOHET NË MBËSHTETJE TË VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE F. 8

LISTA SERBE FITOI NË KATËR KOMUNAT VERIORE F. 5

EKONOMI

PROJEKTLIGJI PËR FINANCIMIN E PARTIVE POLITIKE NUK SIGURON TRANSPARENÇË F. 9

KONTROLLORËT E TRAFIKUT AJROR PARALAJMËROJNË SËRISH GREVË F. 9

KULTURË

ENVER DUGOLLI PROMOVON LIBRIN PËR MASAKRËN E DUBRAVËS F. 6



SPORT

RAMAJ: DUAM SUKSESE EDHE NË EVROPË F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ | FAQE 4-5

LDK-ja dhe LV-ja gabuan rëndë që lëshuan seancën për tribunalin

Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka deklaruar se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje gabuan rëndë që lëshuan seancën në të cilën po diskutohej për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Në këtë

intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se këto dy subjekte opozitare me këtë veprim kanë dërguar mesazhin e keq se Kuvendi nuk është unik as për krimet serbe në Kosovë. Sipas deputetit të AAK-së, përtej çdo motivi nisma e Kuvendit për të krijuar një mekanizëm që kërkon drejtësi për krimet e kryera në Kosovë është legale dhe legjitime

MBAHET TAKIMI KOORDINUES NË MES TË DELEGACIONIT TË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË PËR MARRËVESHJET E NËNSHKRUARA NGA Mbledhja e Përbashkët e dy Qeverive

Limaj: Qershori është afati i fundit për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Pejë

Muaji qershor duhet të jetë afati i fundit për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë. Kështu ka deklaruar koordinatori

kombëtar i dy qeverive, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, në takim koordinues në Tiranë lidhur me marrëveshjet e nënshkruara më 26 nëntor të 2018-s në mbledhjen e



përbashkët në Pejë. Ai ka thënë se koordinimi i aktiviteteve nga të dyja palët dhe qasja e mirëfilltë garantojnë zbatimin e marrëveshjeve mes dy vendeve | FAQE 3

Veseli: Tribunali do të ndodhë. E ftoj opozitën të jetë në seancë kur të votohet | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama: Zgjedhjet bëhen për ata që zgjedhin

TRANË, 20 MAJ - Gjatë takimit me koordinatorët e platformës së bashkëqeverisjes, ku u prezantuan rastet e zgjidhura, kryeministri Rama u shpreh se ka diferencë mes trajtimit të ankesave nga institucionet e qeverisjes qendrore dhe degëve të tyre në rrethe dhe nga bashkitë, por kjo do të ndryshojë pas zgjedhjeve të 30 qershorit. "Më vjen mirë që të them se numri i halleve dhe i problemeve të trajtuara dhe zgjidhura ka prekur kufirin e 35 mijë.

Sigurisht nuk janë të gjitha halle, janë dhe probleme të natyrave të ndryshme që lidhen me aspekte të ndryshme të qeverisjes për të cilat qytetarët shkruajnë. Nga ana tjetër dua të nënvizoj se ka një diferencë, e cila meriton vëmendje midis halleve dhe problemeve që zgjidh qeveria përmes ndërhyrjes së agjencisë që administron platformën tek institucionet qendrore. Qofshin ato institucione qendrore në Tiranë apo përfaqësi të institucioneve

nëpër qarqe. Dhe, nga ana tjetër e nivelit sasior dhe cilësor jo të pëlqyeshëm të trajtimit të ankesave në qeverisjen nga bashkitë", tha Rama. Ai tha se çka ne do të realizojmë është që, qasja e drejtpërdrejtë te çdo kryetar dhe kryetare bashkie pas 30 qershorit të jetë i së njëjtës cilësi. Ky është një moment shumë i rëndësishëm dhe është po aq e rëndësishme të nënvizohet se zgjedhjet nuk bëhen për ata që zgjidhen, por bëhen për ata që zgjedhin.



Pendarovski dekreton ligjet e panënskruara nga Ivanovi

- Me të marrë detyrën, presidenti i ri i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, vendosi t'i dekretojë disa ligje reformuese që për një kohë mbetën të bllokuara si rrjedhojë e mosdekretimit nga ish-presidenti i Maqedonisë së Veriut, Gjorge Ivanov
- Ligjet reformuese për një kohë mbetën të bllokuara si rrjedhojë e mosdekretimit nga ana e ish-presidentit të Maqedonisë së Veriut, Gjorge Ivanov, i cili kishte refuzuar t'i nënskruajë ato, për arsye se në këto ligje figuronte emri i ri i shtetit, Maqedonia e Veriut



SHKUP, 20 MAJ - Bllokimi i ligjeve reformuese ka shkakuar ngecje të mëdha në transformimin e institucioneve të shtetit, në përputhje me vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian, thonë analistët në Maqedoninë e Veriut.

Ka mbetur më pak se një muaj kohë para se Brukseli të vendosë rreth caktimit të datës për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në BE. Sipas ekspertëve, nënskrimi i një pjese të madhe të ligjeve nga presidenti i ri i vendit, Stevo Pendarovski, do t'i japë shtytje procesit të integritetit të vendit por, megjithatë, ata druajnë se periudha njëmuajore është kohë e shkurtër që këto ligje të zbatohen në praktikë.

"Është mirë që presidenti i ri i shtetit nuk humb kohë, përkatë-

sisht i është përveshur punës së dekretimit të ligjeve evropiane. Pavarësisht se ka ose jo kohë të mjaftueshme që ligjet reformuese të arrijnë të gjejnë zbatim në praktikë, mendoj se institucionet evropiane janë të vetëdijshme për relacionet që ka pasur Parlamenti me Presidencën e shtetit dhe e gjithë kjo duhet të notohet pozitivisht", tha Mersel Bilalli. "Së fundmi, më tepër vlerësimi i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut do të jetë politik për shkak të ndryshimit të emrit të shtetit", thotë për "Radion Evropa e Lirë", Mersel Bilalli, ish-këshilltar në Presidencë.

Ndryshe, me të marrë detyrën, presidenti i ri i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, vendosi t'i dekretojë ligjet që kanë të bëjnë me punën e gjykatave:

Ligjin për punën e administratës shtetërore, Ligjin për Energjetikën, Ligjin kundër diskriminimit, Ligjin për qasjen e lirë në informacionet me karakter publik dhe shumë ligje të tjera.

Në funksion të një shtytjeje për proceset integruese, u zhvillua edhe takimi i së hënës ndërmjet presidentit Stevo Pendarovski dhe kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferi. "Presidenti Pendarovski dhe kryetari Xhaferi kanë shkëmbyer mendime për gjendjen aktuale në Maqedoninë e Veriut. Të dy bashkëfolësit e kanë theksuar rëndësinë e të gjitha institucioneve relevante

në shtet, që në periudhën e ardhshme t'u japin kah kapaciteteve të përgjithshme drejt realizimit të hapit të ardhshëm të rëndësishëm në integrimin evropian të Maqedonisë së Veriut - caktimit të datës për fillimin e bisedimeve hyrëse me Bashkimin Evropian", thuhet në kumtesën e Presidencës së Maqedonisë së Veriut.

Në këtë drejtim ish-ambasadori i Maqedonisë së Veriut në Bruksel, Nano Ruzhin, thotë se duhet të realizohen detyrimet që ka marrë Maqedonia e Veriut, me qëllim që të marrë një raport pozitiv nga Komisioni Evropian

sa i përket caktimit të datës për fillimin e bisedimeve.

Ruzhin, megjithatë, thotë se rol të rëndësishëm në këtë drejtim do të kenë rezultatet nga zgjedhjet për Parlamentin Evropian. "Si do të jetë rezultati nga këto zgjedhje, i tillë do të jetë dhe fati i Republikës së Maqedonisë së Veriut", thotë Ruzhin.

Ligjet reformuese për një kohë mbetën të bllokuara si rrjedhojë e mosdekretimit nga ana e ish-presidentit të Maqedonisë së Veriut, Gjorge Ivanov, i cili kishte refuzuar t'i nënskruajë ato, për arsye se në këto ligje figuronte emri i ri i shtetit, Maqedonia e Veriut.


Basha: Dhunimi i lirive të njeriut, shkak për përmbysjen e çdo pushteti

TRANË, 20 MAJ - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, gjatë vizitës së tij në Angli është ndaluar edhe te dokumenti 800-vjeçar që ka frymëzuar betejet më madhështore për liri "Magna Carta". "Këtë foto e mora nga panelet e Westminster, ndërtesës historike të Parlamentit Britanik,

nënës së gjithë parlamenteve", ka bërë me dije Basha. "Është Magna Carta, dokumenti 800-vjeçar që ka frymëzuar betejet më madhështore për liri në botë këto 8 shekuj, nga Reforma e Monarkisë Britanike, te Revolucioni Amerikan dhe ai Francez. Madhështia e saj qëndron tek

ideali i shenjtë dhe parimi bazë i demokracisë perëndimore se liria dhe të drejtat e njeriut mbrohen me ligj dhe se dhunimi i tyre është shkak për përmbysjen e çdo pushteti", tha kreu i PD-së. "Magna Carta është mantra e kufizimit të pushtetit me ligj dhe ndërtimit të shoqërisë mbi barazinë para

ligjit dhe respektin për të drejtat dhe liritë e çdo njeriu. Magna Carta është Karta e Madhe që e bëri Britaninë të Madhe, sepse vendosi precedentin se mbi të drejtat dhe dinjitetin e njerëzve nuk ka pushtet mbi tokë, përveç pushtetit të njerëzve, nga njerëzit dhe për njerëzit", theksoi Basha.



Mbahet takimi koordinues në mes të delegacionit të Kosovës dhe Shqipërisë për marrëveshjet e nënshkruara nga mbledhja e përbashkët e dy qeverive

Limaj: Qershori është afati i fundit për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Pejë

Muaji qershor duhet të jetë afati i fundit për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë. Kështu ka deklaruar koordinatori kombëtar i dy qeverive, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, në takim koordinues në Tiranë lidhur me marrëveshjet e nënshkruara më 26 nëntor të 2018-s në mbledhjen e përbashkët në Pejë. Ai ka thënë se koordinimi i aktiviteteve nga të dyja palët dhe qasja e mirëfilltë garantojnë implementimin e marrëveshjeve mes dy vendeve



EPOKA
ERE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 20 MAJ - Në Tiranë të hënën është mbajtur takimi i dytë koordinues ndërmjet delegacioneve të Kosovës dhe Shqipërisë lidhur me marrëveshjet e nënshkruara në mbledhjen e dy qeverive të mbajtur më 26 nëntor në Pejë. Me këtë rast koordinatori kombëtar i dy qeverive, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, ka thënë se koordinimi i aktiviteteve nga të dyja palët dhe qasja e mirëfilltë do ta garantojnë implementimin e marrëveshjeve mes dy vendeve tona. "Ajo që mund të them me kënaqësi është se nga katër marrëveshjet e arritura në Pejë ka pasur progres dhe do të shohim ku jemi me katër marrëveshjet e nënshkruara", ka deklaruar Limaj, duke shtuar se, ashtu siç janë pajtuar, muaji qershor duhet të jetë afati i fundit për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Pejë. Sipas Limajt, takimi i së hënës i jep peshën e duhur dhe është një rëntgen i krejt asaj që është arritur nga nëntori i vitit 2018 e këndeje. "Ky takim koordinues ka për qëllim trajtimin e çështjeve të identi-

fikuara nga takimi i parë, që nënkupton se diskutimi orientohet në sfidat që kërkojnë veprime konkrete nga organet zbatuese të të dy vendeve. Pra, konsiderojmë se koordinimi i aktiviteteve nga të dyja palët do të garantojë zbatimin e këtyre marrëveshjeve në mes të dy qeverive tona. Nga katër marrëveshjet që kemi arritur në mbledhjen e dy qeverive në Pejë ka pasur një përparim, ta shfrytëzojmë rastin të shohim ku jemi me katër marrëveshjet e nënshkruara. Ashtu siç jemi pajtuar, qershori do të jetë afati i fundit për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Pejë", është shprehur Limaj. Ndërkaq zëvendëskryeministri i Shqipërisë, Erion Braçe, ka thënë se puna dhe sfidat kryesore mbesin të fushat: tregu, shërbimet dhe lëvizshmëria, siguria, kultura e diaspora dhe aksioni diplomatik e bashkëpunimi politik. "Për sa i takon tregut, shërbimeve dhe lëvizshmërisë me Kosovën ashtu sikundër dhe me katër vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, po punojmë për krijimin e një zone ekonomike të përbashkët në rajon, ku legjislacioni i vendeve tona lehtëson tregtinë dhe lëvizjen e lirë të

njerëzve dhe mallrave, në të njëjtën kohë është i përafuar edhe me legjislacionin e BE-së", ka theksuar ai.

Në këtë drejtim Braçe ka veçuar marrëveshjen rajonale të nënshkruar në mars të vitit 2019 për roaming, e cila do të ketë efekte reale në tarifat telefonike, duke filluar nga 1 korriku i këtij viti. "Po ashtu, vetëm në rrafshin dypalësh me Kosovën kemi një marrëveshje për lehtësimin e tarifave roaming. Përputhshmëria mes këtyre dy marrëveshjeve do të diskutohet edhe nga ministrat respektivë të institucioneve të linjës", është shprehur Braçe.

Një tjetër çështje e rëndësishme ai ka thënë se është edhe protokollin për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Morinë-Vërmicë. Braçe ka thënë se është komplekse marrëveshja për hapjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar por, sipas tij, nëse punohet, mund të arrihet. "Në funksion të hapjes së tregjeve tona ne kemi punuar ngushtësisht në muajt e fundit për heqjen e vështirësive të tejkaluara në kohë e kalimit të kufijve të lëvizshmërisë së njerëzve. Por heqja e pengesave të kalimit kufitar ka edhe një aspekt të rëndësishëm sigurie, sa kombëtare aq edhe rajonale dhe evropiane. Menaxhimi i kufijve është një çështje komplekse, gati-gati një sfidë në vete, por nëse bashkëpunojmë dhe bashkërendojmë punët ndërmjet struktura-

Marrëveshjet e nënshkruara në mes të Kosovës dhe Shqipërisë më 26 nëntor në Pejë

1. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe të informimit të diasporës;
2. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen reciproke të patentë shoferëve;
3. Protokollin për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Morinë - Vërmicë në mes të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë;
4. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e borxhit publik, financimeve të huaja dhe marrëdhëniet me institucionet financiare ndërkombëtare;
5. Marrëveshja për heqjen e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet ministrive përgjegjëse për

fushën e komunikimeve elektronike të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës;

6. Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e rinisë;

7. Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunim në fushën e shëndetësisë;

8. Protokollin ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, për njohjen bilaterale dhe unifikimin e modeleve të certifikatave shëndetësore, veterinarë dhe fitosanitare që do t'i shoqërojnë ngarkesat e kafshëve të gjalla, produktet me origjinë shtazore dhe produkte bimore gjatë importit, eksportit dhe transitit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës;

9. Memorandumin i mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë për Pronësinë Industriale të RKS-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë.

rave tona, sfida bëhet shumë herë më e menaxhueshme. Ne synojmë ta realizojmë menaxhimin e integruar të kufijve përmes pikave

të përbashkëta të kalimit kufitar për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar", është shprehur Braçe.

Fillon bashkëpunimi konkret ndërmjet QKUK-së dhe HUG-it të Gjenevës

PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Një delegacion i zyrtarëve të Qendrës Klinike Universitare të Gjenevës (HUG) po qëndron në Kosovë dhe po diskuton për hapat konkretë të bashkëpunimit ndërmjet HUG-it dhe SHSKUK-së. Vizita po realizohet me ndërmjetësim të Odës Zvicër - Kosovë, Konsullatës së

Kosovës në Gjenevë, në bashkëpunim me SHSKUK-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Në këtë takim është biseduar për krijimin e ekipeve të përbashkëta dhe për përgjegjësitë për komunikim ndërkolegjial dhe ndërmenaxherial të kryeinfermiereve dhe drejtorëve të klinikave.

Është diskutuar, gjithashtu, për mundësinë e këmbimit të përvojave për stafin menaxherial, përfshirë mjekë dhe infermierë. Po ashtu, është folur që stafi me ekspertët nga HUG të ndihmojë në hartimin e rregullores dhe protokolleve të punës që do të zbatohen në QKUK.



Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

LDK-ja dhe LV-ja gabuan rëndë që



Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka deklaruar se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje gabuan rëndë që lëshuan seancën në të cilën po diskutohej për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se këto dy subjekte opozitare me këtë veprim kanë dërguar mesazhin e keq se Kuvendi nuk është unik as për krimet serbe në Kosovë. Sipas deputetit të AAK-së, përtej çdo motivi nisma e Kuvendit për të krijuar një mekanizëm që kërkon drejtësi për krimet e kryera në Kosovë është legale dhe legjitime

kryera në Kosovë, është legale dhe legjitime", ka thënë Nitaj. Deputeti i AAK-së ka folur edhe për iniciativën e re të opozitës për ta rrëzuar Qeverinë. Ai ka deklaruar se kësaj historie që po dëgjohet që një vit i ka dalë boja. "Po kërkojnë vota edhe nga pozita, veç kurrë nuk e kanë kuptuar nëse mund të llogarisin, qoftë edhe në të gjitha votat, që formalisht janë në taborin e tyre. Unë nuk do të isha aq i sigurt. Populli thotë se fjalët e tepërta janë fukarallëk. Ata që e kanë fuqinë e numrat, nuk flasin hiç, por veprojnë", ka thënë Nitaj.

pa fund, ku deputetët i lexonin fjalimet e tyre të gjata, me gjasë edhe fjalime të shkruara nga një dorë, por do të duhej të ishte një seancë që prodhon rezultat. Shumica parlamentare ende nuk e ka kuptuar se nuk e ka aleate opozitën për asnjë gjë. Bash për asnjë gjë. As për projektet e nismat që mund të klasifikohen nisma të interesit kombëtar. Ajo e ka nxjerrë shpatën mbi setër dhe po provon t'ia presë kokën kësaj qeverie. Natyrisht, nëse mundet. Prandaj liderët e shumicës parlamentare do të duhej të ishin mobilizuar për t'i sjellë në Kuvend deputetët e tyre, e jo siç po ndodh tash e sa kohë, edhe sot, të mungojnë një numër i konsiderueshëm i deputetëve të shumicës. Për sa i përket kundërshtimit të LDK-së dhe të LV-së, për mua braktisja e seancës prej tyre ka qenë një gabim i rëndë i tyre. Unë do ta kuptoja braktisjen e të gjitha seancave, por jo edhe të seancës ku flitet për krijimin e një mekanizmi që kërkon drejtësi për krimet e kryera në Kosovë.

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 20 MAJ - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, e ka vlerësuar gabim të rëndë veprimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje për ta braktisur seancën parlamentare, në të cilën po flitej për themelimin e një tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Ai ka thënë se çfarë ka ndodhur të hënën në seancë është

për të ardhur keq. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se mazhoranca duhet të kuptojë një herë e mirë se opozitën nuk e kanë aleate as për iniciativa që lidhen me interesin kombëtar. "Sa i përket kundërshtimit të LDK-së dhe LV-së, për mua braktisja e seancës prej tyre ka qenë gabim i rëndë i tyre. Unë do ta kuptoja braktisjen e të gjitha seancave, por jo edhe të seancës ku flitet për krijimin e një mekanizmi që kërkon drejtësi për krimet e

kryera në Kosovë", ka thënë Nitaj. Me këtë veprim, sipas tij, dy subjektet opozitare e kanë dërguar mesazhin e keq se Kuvendi nuk është unik as për krimet serbe në Kosovë. "Unë druaj se sot LDK-ja dhe LV-ja, besoj pa vetëdije, e kanë dërguar një mesazh të keq, se Kuvendi i Kosovës nuk mund të bjerë në një zë, as për krimet serbe në Kosovë. Fundja, përtej motiveve që mund t'i ketë kushdo qoftë, nisma e Kuvendit për të krijuar një mekanizëm që kërkon drejtësi për krimet e

"Epoka e re": Z. Nitaj, deputetët e LDK-së dhe Vetëvendosjes e lëshuan sallën e Kuvendit, në të cilën po diskutohej për krijimin e një komisioni për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia i ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Si e keni parë këtë veprim të tyre? **Nitaj:** Është për të ardhur keq çfarë ka ndodhur në seancën e së hënës të Kuvendit. Kjo seancë nuk do të duhej të ishte një seancë e debateve

lëshuan seancën për tribunalin



"Epoka e re": Z. Nitaj, pretendimet e tyre janë se ky tribunal nuk mund të bëhet. Sa sfiduese për Kosovën do të jetë që të arrijë ta bindë bashkësinë ndërkombëtare për themelimin e një tribunali të tillë?

Nitaj: Kjo është një çështje tjetër. Pretendimet e tyre mund të jenë edhe të bazuara. Edhe unë shembull kam dilemat e mia sa i përket nismës së zotit Veseli për krijimin e këtij tribunali. Se si do të krijohet ai, cila është baza ligjore, cili do të jetë rezultati i tij, e kështu me radhë. Por kjo nuk do të thotë që një nismë e tillë duhet të përmbysset ende pa u artikuluar mirë. Unë druaj se sot LDK-ja dhe LV-ja, besoj pa vetëdije, e kanë dërguar një mesazh të keq, se Kuvendi i Kosovës nuk mund të bjerë në një zë as për krimet serbe në Kosovë. Fundja, përtej motiveve që mund t'i ketë kushdo qoftë, nisma e Kuvendit, për të krijuar një mekanizëm që kërkon drejtësi për krimet e kryera në Kosovë, është legale dhe legjitime.

"Epoka e re": Me iniciativën e LDK-së opozita sërish ka aktivizuar iniciativën për rrëzimin e qeverisë. I frikësohet qeveria kësaj initiative?

Nitaj: Unë nuk e di nëse qeveria i frikësohet një nisme të

tillë, sepse ajo flet vetë, por e di se ka më shumë se një vit që e dëgjojmë historinë se si opozita do ta rrëzojë qeverinë dhe kësaj pune i ka dalë boja. Kemi dëgjuar lloj-lloj margaritarësh se si do ta kryejnë këtë operacion. Po kërkojnë vota edhe nga pozita, veç kurrë nuk e kanë kuptuar nëse mund të llogarisin, qoftë edhe në të gjitha votat, që formalisht janë në taborin e tyre. Unë nuk do të isha aq i sigurt. Populli thotë se fjalët e tepërta janë fukarallëk. Ata që e kanë fuqinë e numrat, nuk flasin hiç, por veprojnë. Por, duket se LDK-ja dhe LV-ja janë në krizë për ide dhe veprime, prandaj dhe po provojnë ta mbajnë elektoratin e vet me këtë historinë e rrëzimit të qeverisë.

"Epoka e re": Sa jeni i kënaqur me funksionimin e koalicionit qeverisës?

Nitaj: Është e vërtetë se koalicioni qeverisës ka qenë përballë sfidave të shumta gjatë vitit të fundit, por edhe sfidat i ka pasur më të mëdha e më të rënda. Veç përballja me Serbinë dhe aleatët e saj në këtë fazë të përmbylljes së projektit të Kosovës, nëse mund të shprehem kështu, ka qenë një detyrë e vështirë, që ka kërkuar edhe mençuri, edhe guxim, diçka që duket të mos ketë qenë e mjaftueshme

në qeverisjet e shkuara. Dhe këtë e di edhe opozita, por ia ka qejfi të mos e pranojë, sepse në këtë vend veç suksesin nuk ta bëjnë hallall. Vlerësoj se kjo qeveri i ka kryer disa punë të rëndësishme. Nuk po dua t'i numëroj sepse ato janë transparente, por vendosmëria e kësaj qeverie dhe e kryeministrit Haradinaj, që të mos lëshojë pe ndaj kërkesave anti-Kosovë të Serbisë, nuk është punë e vogël. Më në fund Kosova po e rikthen zërin dhe fuqinë e vet, edhe brenda, edhe jashtë. Unë nuk dua ta amnistoj qeverinë për gabimet eventuale të saj, sepse askush nuk mund të jetë imun nga gabimet, por për mua është i rëndësishëm përcaktimi dhe përkushtimi i qeverisë dhe i kryeministrit në raport me problemet që i ka vendi dhe ato janë tepër të sakta dhe në përputhje me interesat e vendit.

"Epoka e re": Edhe disa zëra brenda koalicionit qeverisës pretendojnë se zgjedhje të reja mund të ketë në vjeshtën e këtij viti. Sa është e mundshme të ndodhë kjo?

Nitaj: Epo tani unë nuk mund ta luaj rolin e Nostradamusit. Në këtë vend asgjë dhe gjithçka është e mundur. Por, siç thotë populli, "t'gamet" nuk janë!

Lista Serbe fitoi në katër komunat veriore

PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Bazuar në rezultatet preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së), kandidatët e Listës Serbe kanë fituar që në rrethin e parë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave veriore të Kosovës.

Zgjedhjet janë mbajtur të dielën në Mitrovicën e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok. Procesi u vlerësua se ka kaluar qetë dhe pa parregullsi të mëdha. Kurse dalja e votuesve, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ishte më e lartë se 42 për qind. Rezultatet preliminare të prezantuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tregojnë se kandidatët e Listës Serbe kanë shënuar fitore bindëse. Në Leposaviq, në bazë të rezultateve preliminare, ka fituar Zoran Todiq nga Lista Serbe me 96.6 për qind të votave. Ai kishte kundërkandidatë Shaqir Hetemin nga Partia Demokratike e Kosovës i cili mori 2 për qind dhe Fisnik Veselin nga Lëvizja Vetëvendosje i cili mori 1.4 për qind të votave.

Në Zubin Potok, Sërnxhan Vulloviq nga Lista Serbe ka fituar 94.5 për

qind, kurse Hysen Mehmeti nga Partia Demokratike e Kosovës 2.9 për qind dhe Liridona Kahrmani nga Lëvizja Vetëvendosje 2.6 për qind të votave.

Edhe në Zvečan kandidati i Listës Serbe, Vuçina Janković, ka fituar me 94.7 për qind, në garë me Ilir Pecin nga Partia Demokratike e Kosovës që ka siguruar 3.3 për qind dhe Avdi Pecin nga Lëvizja Vetëvendosje me 2 për qind të votave.

Në Komunën Mitrovica e Veriut, kandidati i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka siguruar 86.2 për qind, kurse kandidatja e Partisë Demokratike të Kosovës, Gonxhe Çausi, 8.7 për qind dhe kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje, Erden Atiq, 5 për qind të votave.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë se procesi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme në komunat veriore ka kaluar mirë dhe pa ndonjë problem. "Të drejtën e votës e shfrytëzuan 24 592 qytetarë apo 42.42 për qind e qytetarëve me të drejtë vote", ka deklaruar Daka.



Presidenti: Masakra e Dubravës, ndër aktet më të rënda gjenocidale të Serbisë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 MAJ - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë të hënën në akademinë përkujtimore për heroin Enver Topalli. Presidenti Thaçi ka thënë se Enver Topalli iu përket veprimtarëve dhe atdhetarëve tipikë të viteve tetëdhjetë. "Viti 1981 kishte bërë kthesë të madhe politike dhe historike për Kosovën dhe kombin. Këtë brez më së miri e përkufizoi profesori Ukshin Hoti, edhe vetë i burgosur në ato vite, i cili kishte theksuar se ky brez ishte kërkues ndaj vetvetes, shquhej për veprimtarë të disiplinuar, të etur për dije, këmbëngulës, njerëz të sigurtë dhe me edukatë të lartë familjare dhe kombëtare", ka theksuar presidenti Thaçi. Sipas tij, intervenimi brutal i policisë jugosllave dhe vlerësimi i demonstratave të 1981-s si kundërrevolucion e kishte bërë

më të qartë vendosmërinë e elementit patriotik për të mos u pajtuar asnjë moment me politikën shtypëse të Beogradit, që kulmoi me ardhjen e Milosheviqit në krye të saj. "Derisa subjektiviteti i Kosovës po rrethohej sistematikisht, nga ana tjetër nuk mungoi organizimi i fshehtë i grupeve klandestine. Shënimi i përvjetorëve të demonstratave, përhapja e shtypit, trakteve dhe pamfleteve nuk u ndal asnjëherë", ka shtuar ai.

I pari i vendit më tej ka thënë se si shumë veprimtarë të asaj kohe, edhe Enver Topalli frymëzohej nga personalitete dhe lëvizje të fshehta atdhetare, që kishin vepruar edhe para ngjarjeve të Pranverës 1981.

Zhvillimet politike kërkonin krijimin e një force të përbashkët, shkrirjen e grupeve të vogla politike në një front të përgjithshëm si brenda Kosovës, ashtu edhe në botën perëndimore ku vepronte një diasporë e fuqishme, ka



vijuar më tej presidenti.

Presidenti Thaçi ka thënë se Enver Topalli ishte i vetëdijshëm për nevojën e bashkimit të fuqive politike të të gjitha grupeve. Sipas tij, për këtë arsye ai qëndron një kohë në botën e jashtme, për t'u kthyer sërish në Kosovë, që ta forcojë organizimin e grupeve të tilla atdhetare. Kreu i vendit ka shtuar se Enver Topalli në jetën e tij e frymëzuan dy personalitete të rëndësishme. "Adem Demaçi, simboli i rezistencës shqiptare, njeriu që u bë ndërgjegjja jonë kombëtare për 28 vjet me radhë nëpër burgjet jugosllave dhe Rexhep Mala, një nga të burgosurit politikë më të qëndrueshëm, që kaloi nëpër tortura çnjerëzore. Prandaj, pas burgosjes, në pro-

cesin gjyqësor të vitit 1984, Enver Topalli para trupit gjykues shfaq idetë e tij patriotike dhe mbron fuqishëm kërkesën për Republikën e Kosovës, me një fjalim mbresëlënës", ka vijuar presidenti.

Presidenti i vendit ka theksuar se Enver Topalli as në vitet 1990 nuk e ndaloi veprimtarinë atdhetare, duke theksuar angazhimin në kuadër të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, të komisioneve të kulturës dhe formave të tjera organizative. "Torturat dhe qëndrimet në burgje ia kishin dëmtuar shëndetin, por kurrë forcën morale, idealin e lirisë dhe vendosmërinë për ta kundërshtuar dhe luftuar administrimin serb në Kosovë", ka shtuar ai.

Presidenti Thaçi ka theksuar se Enver Topalli arrestohet disa herë edhe gjatë viteve të nëntëdhjetë, për të t'u burgosur në vitin 1998, kur në Kosovë filloi lufta e hapur e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me forcat ushtarake dhe policore serbe. "Fatqësisht, më 19 maj 1999 Enver Topalli vritet në burgun e Dubravës. Të burgosurit shqiptarë, si të thuhet, me duar të lidhura, vriten në mënyrën më mizore brenda burgut", ka thënë presidenti Thaçi.

I pari i vendit më tej ka shtuar se duke e kujtuar Enver Topallin, kujtojmë të gjithë të burgosurit që u vranë, që u plagosën dhe u keqtrajtuat në Burgun e Dubravës. "Krimi i kryer në Dubravë hyn në radhën e akteve më të rënda gjenocidale që shteti i Serbisë ka kryer në Kosovë gjatë viteve 1998-1999", ka theksuar ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se që nga marsi e deri më sot kudo nëpër Kosovë po kujtohen krimet, masakrat, djegiet, aktet e shfarosjes dhe spastrimit etnik deri në përmasat e gjenocidit. "Askush, edhe pas 20 vjetëve, nga urdhërdhënësit dhe ekzekutorët e këtyre krimeve, nuk doli para drejtësisë ndërkombëtare ose vendore", ka theksuar presidenti.

Duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, presidenti Thaçi ndau urdhrin "Hero i Kosovës" për Enver Topallin në njëzetvjetorin e rënies.



Enver Dugolli përruron librin për masakrën e Dubravës

PRISHTINË, 20 MAJ - Në kuadër të 20-vjetorit të masakrës së Dubravës, të hënën është përruruar libri i kujtimeve "Qark i (pa)mbyllur burgjesh" i autorit Enver Dugolli, i mbijetuar i masakrës së Dubravës. Libri përmban kujtime nga kohë të

vështira burgjesh në atë kohë në Dubravë.

Ish i burgosuri politik, Hydajet Hyseni, ka thënë se Enveri është dëshmitar i gjallë e tipik i njerit dhe tjetrit në kontekst, por edhe i tërmecës midis tyre, si dhe gjithçka që rrëfëhet në kohën dra-

matike të burgut. Ky libër i kujtimeve, sipas tij, është një monument i veçantë kushtuar qindra të rinjve të rënë në burgun e Dubravës.

Hyseni foli edhe për vuajtjet e veprimtarit Ukshin Hoti dhe të tjerëve. "Nuk dihet a do të ngritet monumenti zyrtarisht i premtuar për Dubravën, por libri i Enver Dugolli tashmë është një monument i llojit të vet dhe një monument i veçantë kushtuar qindra jetëve rinore, e dëshmorë të vranë. Libri i Enverit është edhe aktakuzë për terrorin shtetëror shovinist, por është edhe zë proteste që e akuzon fuqishëm dhe me fakte cinizmin e qendrave të vendimmarrjes politike vendore dhe të mekanizmave të drejtësisë ndërkombëtare që vazhdojnë të heshtin mbi krimin e gjenocidit në Burgun e Dubravës", ka thënë Hyseni.


Redaktori i librit "Qarku i (pa)mbyllur burgjesh", Elvis Hoxha, ka theksuar se në këtë libër sheh një përpjekje që autori e thotë dësh-



minë që ka munguar deri tash, ngaqë fjala dëshmi është shumë e fortë dhe shumë e ftohtë. "Ne kemi pasur qaq shumë vuajtje sa nuk kemi pasur kohë të dëshmojmë. '99-ta për mua ishte datë e madhe se ne, më në fund, do të dëshmonim institucionalisht, por ja që para sa vitesh ne nuk dëshmuam, por themeliam Gjykatën Speciale. Unë prisja që ne akademikisht të fillonim të rrëfenim. Prandaj, unë e

quaj këtë libër, libër të parë dëshmi", është shprehur Hoxha.

Ndërkaq për autorin e librit Enver Dugolli botimi i këtij libri do të kontribuojë në zbardhjen e së vërtetës së Dubravës dhe vënien në vend të drejtësisë. Dugolli ka potencuar gjatë promovimit të librit të tij, se për masakrën e Dubravës duhet shkruar edhe më pasi, siç ka thënë ai, ka mbetur ende shumë për t'u thënë.



Kuvendi i Kosovës ka mbajtur debat parlamentar për krijimin e një komisioni për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia i ka kryer gjatë luftës në Kosovë

Veseli: Tribunali do të ndodhë. E ftoj opozitën të jetë në seancë kur të votohet

Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së) dhe ata të Lëvizjes Vetëvendosje (LV-së) e kanë lëshuar të hënën sallën e Kuvendit të Kosovës në të cilën po diskutohej për krijimin e një komisioni për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia i ka kryer gjatë luftës në Kosovë. Në përfundim të debatit parlamentar, kryeparlamentari Kadri Veseli i ka siguruar të gjithë se tribunali do të ndodhë. Ai e ka ftuar opozitën të jetë pjesë e kësaj seance kur të votohet komisioni për themelimin e tribunalit ndërkombëtar



Veseli i ka siguruar edhe familjarët e të pagjeturve dhe viktimave të gjenocidit serb në Kosovë se iniciativa për tribunalin do të shkojë deri në fund dhe kriminelët serbë do të dalin para drejtësisë. "Sot në Kuvend nuk është dashur të ketë parti politike, sepse kur janë vvarë qytetarët tanë, Serbia nuk i ka ndarë njerëzit tanë në parti. Sot, pavarësisht çdo interesi apo

besoni është pasojë e vet asaj çfarë ka kaluar populli jonë. Ju si familjarë duhet ta dini se zëri juaj do të dëgjohet jo vetëm këtu në Kosovë, por edhe në Kongresin Amerikan, edhe në Bundestagun Gjerman dhe në çdo parlament të vendeve demokratike ku i thuhet jo mohimit të gjenocidit të krimeve kundër njerëzimit", ka thënë Veseli.

inati, është dashur të ketë vendim të mençur, të matur, me qëllim vetëm të ardhmen. Kjo iniciativë nuk do të ndalet. As që mund ta ndalë dikush. Për familjarët që sot janë në sallë, por edhe për të gjithë ata familjarë që kanë pësuar gjatë luftës së fundit dhe të gjitha luftërave që janë bërë në Kosovë, e kam këtë mesazh: Mos u shqetësoni, edhe kjo çfarë ka ndodhur sot,

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 MAJ - Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe ata të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) e kanë lëshuar të hënën sallën e Kuvendit të Kosovës në të cilën po diskutohej për krijimin e një komisioni për themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet që Serbia i ka kryer gjatë luftës në Kosovë.

Deputetët e dy partive politike opozitare thanë se kjo është një tallje me qytetarët, pasi një tribunal i tillë mund të krijohet vetëm nga Kombet e Bashkuara.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se lëshimi i seancës nga opozita jo vetëm se është një gjë e turpshme, por edhe e pagximshme. "Nuk mund të besoj se edhe sot, 20 vjet pas luftës, të dëgjojmë deklaratatë të tilla. Është vështirë të gjenden fjalë për këtë mentalitet të ikjes nga përgjegjësitë", ka thënë Krasniqi.

Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, tha

se është e pakuptimtë se si deputetët e opozitës e kanë lëshuar seancën, ndërsa Bilall Sherifi, nga Nisma Socialdemokrate, ka theksuar se puna duhet të vazhdojë dhe se kriminelët që kanë kryer krime, duhet të dënohen.

Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, u ka bërë thirrje deputetëve të opozitës që t'i lënë anash inatet politike e ta mbështesin iniciativën për formimin e tribunalit për gjenocidin dhe krimet serbe në Kosovë.

Në përfundim të debatit parlamentar, kryeparlamentari Veseli i ka siguruar të gjithë se tribunali do të ndodhë. "Unë kam këtë thirrje për vëllezërit tanë të opozitës nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje. Është mirë me qenë në sallë kur të votohet. Kjo do të votohet. Por është mirë që edhe ata të jenë në sallë dhe ta votojmë bashkërisht. Ju kam thirrur dhe do t'ju thërras çdoherë kurdo që kërkoni. Nëse jeni hidhëruar pse e kam filluar unë këtë iniciativë, unë jam i gatshëm t'ia bëjmë si të doni. Por, ajo çka është kryesore, është që duhet të votohet", ka thënë Veseli.

Maqedonia e Veriut i njeh patentshoferët e Kosovës

Prishtinë, 20 maj - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut e ka ratifikuar marrëveshjen me Republikën e Kosovës për njohjen reciproke të lejeve për vozitje bazuar në marrëveshjen e arritur mes dy shteteve më 28 janar 2019. "Me qëllim të përmirësimit të sigurisë në komunikacionin rrugor në territoret e shteteve nënshkruese të marrëveshjes, dy palët, në mënyrë reciproke, i njohin lejet e vozitjes, të lëshuara në territoret e shteteve të tyre në bazë të qën-

drimit të rregullt të përcaktuar nga institucionet përkatëse", thuhet në nenet e marrëveshjes së ratifikuar.

Marrëveshja është mbështetur nga të gjithë deputetët, përfshirë edhe ata të partisë opozitare VMRO DPMNE, por vërejtja e tyre ka pasur të bëjë me zvarritjen e procedurave për nisjen e punimeve ndërtimore për autostradën Shkup - Bllacë, që lidh Maqedoninë e Veriut me Republikën e Kosovës. Deputeti Ilija Dimovski ka thënë se janë



të pakuptimta vonesat e autoriteteve kur kihet parasysh fakti se pala e Kosovës e ka përfunduar pjesën e vet të autostradës Prishtinë - Shkup. Sipas deputetit të opozitës maqedonase, qeveria ka dështuar në premtimin e saj për ndërtimin e infrastrukturës me shtetin fqinj.

Nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut është njoftuar se projekti është në përfundim e sipër, ndërsa punimet pritet të nisnin gjatë këtij viti.

Protestohet në mbështetje të viktimave të dhunës seksuale

PRISHTINË, 20 MAJ - Me moton "Më trajto dinjitetshëm", disa organizata joqeveritare kanë marshuar të hënën shesheve të Prishtinës në mbështetje të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Marshi në mbështetje të grave të dhunuara është mbajtur edhe si protestë dhe mospajtim me publikimin e një fotografie me pamje të rënda grafike nga ana e deputetes së Kuvendit të Kosovës, Flora Brovina.

Fillimisht, deputetja Brovina pretendonte se me këtë fotografi po paraqiste dëshmi të dhunës seksuale ndaj një gruaje 35 vjeçare nga Kosova nga ana e disa ushtarëve të Ushtrisë së Serbisë gjatë luftës së fundit, por më vonë doli të jetë një fotografi e falsifikuar, e cila, me gjasë, ishte marrë nga një faqe interneti me përmbajtje pornografike. Për këtë gjest, Brovina kishte pranuar gabimin dhe u kishte kërkuar falje të gjithë

atyre të cilëve kjo fotografi u ka shkaktuar tronditje.

Publikimi i fotografisë nga deputetja Brovina, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, i ka shkaktuar dëm shumë të madh shoqërisë së Kosovës dhe punës së deritashme me viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Dhe për këtë, sipas tyre, përgjegjësinë duhet të bartë Kuvendi i Kosovës.

Feride Rushiti, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës, e cila tash e 20 vjet punon për rehabilitimin e grave që kanë përjetuar dhunë seksuale, tha se fotografia e publikuar javën e kaluar ka rikthyer traumat e luftës të mbijetuarat e dhunës seksuale. "Të mbijetuarit kërkojnë që pamje të tilla nuk kanë vend në Kuvend, por në gjykatë. Ne po vuajmë në heshtje e ju po na godisni me dhimbjen tonë. Duam drejtësi, por nuk duam që vuajtjet



tona t'i shohin fëmijët tanë. Nuk do të lejojmë që publikimi i një fotoje në Kuvendin e Kosovës ta përmbysë një proces të tërë të ndërtuar me shumë mund dhe sakrificë", ka thënë Rushitaj.

Kosova ka katër organizata joqeveritare, të cilat janë marrë me çështjen e femrave të dhunuara duke ofruar shërbime të nevojshme për to. Një nga këto

organizata është edhe Shoqata "Medica" nga Gjakova, që për mision ka ta përmirësojë gjendjen mendore dhe fizike të grave të mbijetuara nga dhuna.

Mirlinda Sada, drejtuese e kësaj shoqate, tha se publikimi i fotografisë ka bërë që puna dhe angazhimi i shoqatës për këtë çështje të kthehet në vitin 1999. Në marsh kanë marrë pjesë ish-

presidentja e Kosovës, Atifeta Jahjaga, ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell dhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës. Sipas përfaqësuesve të organizatave joqeveritare që merren me këtë çështje, rreth 20 mijë konsiderohet numri i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit. (REL)

Qasja dhe lehtësimi i zbatimit të komunikimit publik, temë diskutimi në mes të KPK-së dhe AGK-së

EPOKA
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 MAJ - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), të udhëhequr nga kryetarja Gentiana Begolli.

Qëllimi i takimit ishte dhënia e njoftimeve të ndërsjella, sqarimeve të nevojshme dhe prezantimi i mundësive për fuqizimin e rolit, misionit dhe bashkëpunimit të Këshillit Prokurorial dhe Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, si dhe monitorimi dhe dhënia e rekomandimeve për funksionalizimin



dhe implementimin sa më të mirë të Rregullores për shërbimin e komunikimit publik në sistemin prokurorial të Kosovës e cila është miratuar së fundmi nga KPK-ja. Në këtë kontekst, kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka njoftuar në hollësi përfaqësuesit e AGK-së për përpjekjet që po bëhen në drejtim

të krijimit të kushteve për një komunikim publik adekuat. Sipas tij, bashkëpunimi është mënyra e vetme për tejkalimin e vështirësive dhe sfidave të përbashkëta që kemi përpara dhe për arritjen e objektivave institucionale për informim të drejtë të qytetarëve dhe avancimin e transparencës së

komunikimit publik.

Ndërsa kryetarja e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, Gentiana Begolli, ka theksuar se AGK-ja përcjell dhe analizon me vëmendje çështjet e ndërsjella, me ç'rast për rregullimin nënligjor të fushës së komunikimit publik në sistemin prokurorial do të gjenden forma profesionale për t'i dhënë vërejtjet eventuale dhe kontributin lidhur me qasjen dhe aspektet që lehtësojnë zbatimin e kësaj rregulloreje të rëndësishme.

Gjithashtu, kryesuesi i KPK-së, Bahri Hyseni, ka propozuar që AGK-ja dhe mediat ta monitorojnë zbatimin e kësaj rregulloreje, ndërsa pas një muaji mund ta mbajmë një takim të hapur për

media në prani të përfaqësuesve të AGK-së, për ta shprehur edhe një herë transparencën dhe, natyrisht, nga ky eveniment do të mund të dilnin rekomandime të qëlluara, të cilat pastaj do t'i integrojmë në fushën e komunikimit publik në të ardhmen.

Me këtë propozim konkret të kreut të KPK-së janë pajtuar përfaqësuesit e AGK-së, të cilët do t'i njoftojnë përfaqësuesit e tyre dhe do të marrin pjesë pas një muaji në takim, në të cilin do të vijnë me rekomandime konkrete profesionale për ta ndihmuar zbatimin praktik të efikasitetit, llogaridhënies dhe transparencës publike në sistemin prokurorial të Kosovës.

Kontingjenti i FSK-së, pjesë e ushtrimit 'Shqiponja 19'



PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), i përbërë prej 37 pjesëtarëve nga Batalioni i Dytë i Reagimit të Shpejtë, u dislokua të dielën për në Republikën e Shqipërisë, për t'iu bashkuar ushtrisë shqiptare në ushtrimin në vendkomandë

"Shqiponja 19".

Para pjesëtarëve që do të marrin pjesë në këtë ushtrim, një fjalë rasti e mbajti komandanti i Brigadës për Reagim të Shpejtë, gjeneralbrigade Fadil Haderjonaj, i cili ua forcoi besimin me mbështetjen e tij, duke i udhëzuar që gjatë përfaqësimit

të Forcës së Sigurisë të Kosovës në këtë ushtrim, të jenë sa më profesionalë, të disiplinuar dhe shembull për pjesëmarrësit e tjerë.

Ushtrimi do të realizohet në periudhën kohore prej 20 deri më 29 maj 2019 dhe do të jetë në aspektin tre shkallësh: Kursi i Lartë i

Oficerit, Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm. Ushtrimi zhvillohet nga Batalioni i Parë i Këmbësorisë i Forcave Tokësore të Shqipërisë dhe Batalioni i Dytë i Reagimit të Shpejtë i FSK-së.

Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës, të cilët po marrin pjesë

në trajnime dhe ushtrime të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit, po stërviten me qëllim që gjatë tërë kohës të jenë sa më të përgatitur për të vepruar dhe punuar në mjedis të kombinuar shumëkombësh si dhe të shkëmbejnë përvoja me shtetet partnere.

Projektligji për financimin e partive politike nuk siguron transparencë

PRISHTINË, 20 MAJ - Pavarësisht prej plotësim-ndryshimit që i është bërë Ligjit për financimin e partive politike, përfaqësuesit e shoqërisë civile konsiderojnë se ai sërish lë hapësirë për fshehje të burimeve të financimit dhe cenon standardet ndërkom-bëtare për financimin e partive politike.

Florent Spahija, ekspert ligjor nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se shoqëria civile kishte kërkuar që të bëhet një ligj më i mirë për financimin e partive politike, por me ndryshimet që i janë bërë, sipas tij, ka dalë një ligj që cenon edhe më shumë transparencën dhe llogaridhënien. "Përfundimi i asaj që ne e kemi parë, pasi që Ligji ka shkuar në Kuvend e tutje në komisione parlamentare, ka dalë që ka ndryshuar kuptimin komplet të asaj që ne kemi kërkuar që sa kohë dhe asaj që ka kërkuar Agjenda për Reforma Evropiane (ERA). Si i tillë, plotësim-ndryshimi që i është bërë këtij Ligji cenon transparencën e subjekteve politike ndaj publikut pasi ua mundëson atyre mospublikimin e emrave të pronarëve apo personave

juridikë. Nëse një kompani jep donacion (partisë politike) atëherë me ligjin e ri pronari mund të mos deklarohet", ka thënë Spahija, duke shtuar se, për më tepër, tavanet e kontributeve në para të gatshme për subjektet politike janë dhjetëfishuar nga 50 në 500 euro. "Po ashtu, janë rritur edhe kuotat e donacioneve, në këtë rast nëse donacioni më parë për fushatë zgjedhore ka qenë 2 000 euro për një person fizik, tashmë është bërë 4 000 euro. Ndërsa për persona juridikë ka qenë 10 000 euro, kurse tani është bërë 20 000 euro", ka thënë Spahija.

Muaj më parë, nga zyra e kryeministrit të Kosovës, ishte iniciuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e partive politike, me qëllim të rritjes së transparencës dhe luftimit të korrupsionit. Ky projektligj ka marrë tanimë dritën e gjelbër nga Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian në Kuvendin e Kosovës, por që me disa nga ndryshimet që janë bërë nuk janë pajtuar dy partitë më të mëdha opozitare: Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje.



Javën e kaluar është mbajtur komisioni parlamentar për legjislacion, por që nuk kishte arritur të shqyrtohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për financimin e partive politike në mungesë kuorumi.

Kryetarja e këtij komisioni, Albulena Haxhiu, pati thënë se partitë opozitare janë kundër këtij projektligji dhe do të kërkojnë që të mos procedohet në Kuvend. "Ky raport përmban shumë probleme dhe natyrisht vota jonë si opozitë është kundër. Adreson interesa private të grupeve e të individëve të caktuar, lejon shuma marramendëse për subjektet politike në kundërshtim me ligjin që

është aktualisht", ka thënë Haxhiu. Transparenca e partive politike, përfshirë edhe publikimin e financave dhe shpenzimeve, përbën edhe një prej kriterëve të domosdoshme të Komisionit Evropian që ua ka vënë të gjitha shteteve aspiruese në procesin e gjatë të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Bazuar në raportet e progresit të Komisionit Evropian, Kosova përbën një prej vendeve që ka probleme me mungesën e transparencës nga partitë politike. Partitë politike në vazhdimësi janë kritikuar se bëjnë shpenzime në shuma më të mëdha financiare krahasuar me mjetet që atyre u ndahen nga buxheti i

Kosovës çdo vit, e që arrijnë vlerën e më shumë se 4 milionë euro.

Florent Spahija nga KDI-ja ka thënë se partive politike me ndryshimet që po i bëhen këtij ligji po iu mundësohet të financohen nga mjete që asnjëherë nuk do të mund t'u dihet prejardhja. "Nëse miratohet ky ligj ashtu siç është vendosur, atëherë subjektet politike do të kenë shumë më pak detyrime ndaj nesh si publik për të treguar se si kanë ardhur tek të ardhurat e tyre dhe do ta shfrytëzojnë këtë ligj për t'i financuar subjektet e tyre politike në mënyrën më të keqe të mundshme përmes parave të cilat nuk ua dimë prejardhjen. Po ashtu, nuk do të dimë se kush ka bërë donacione deri në 500 euro me para të gatshme dhe shteti asnjëherë nuk do të ketë mundësi që ato donacione deri në 500 euro të shoh nëse ai person që i ka dhënë ka pasur mundësi t'i japë ato para", është shprehur Spahija.

Shoqëria civile javën e kaluar, me moton "Paratë tona, standardet tona", ka nisur fushatën për kundërshtimin e miratimit të Projektligjit për financimin e subjekteve politike në Kosovë.

Kontrollorët e trafikut ajror paralajmërojnë sërish grevë



PRISHTINË, 20 MAJ (ER) - Shoqata Sindikale e Kontrollorëve të Trafikut Ajror të Kosovës ka paralajmëruar se do të hyjë sërish në grevë. Përmes një njoftimi për media, kjo sindikatë ka njoftuar se do të hyjë në grevë, pasi nuk janë përmbushur kërkesat e tyre. "Sot, më 20. 4. 2019, janë bërë 86 ditë që nga data e nënshkrimit të MOU në mes të MIT dhe SINKON. Përkundër insistimeve të SINKON për takim me MIT si dhe kërkesave për zbatim të marrëveshjes në afat kohor të përcaktuar, SINKON nuk ka marrë përgjigje konkrete apo

zyrtare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit. Për t'u dhënë hapësirë krerëve të institucioneve, respektivisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, anëtarësia e SINKON njëzëri vendosi të shpallë grevë paralajmëruese në kohëzgjatje njëorëshe më datë 27. 5. 2019 (prej orës 08:00 deri në orën 09:00). Ndërsa më datën 28. 5. 2019 greva do të zgjasë prej orës 08:00 deri në orën 16:00. Duke qenë se Ligji për Grevë në nenin 17 njeh kontrollin e trafikut ajror si shërbim jetik, gjatë kohëzgjatjes së grevës kontrollorët do ta siguro-

jnë minimumin e procesit të punës duke u ofruar shërbime të trafikut ajror fluturimeve ushtarake, shtetërore dhe ambulatore në Kosovë", është thënë në njoftimin për media. Kontrollorët e trafikut ajror ishin të pakënaqur me miratimin e Ligjit për Paga, me ç'rast patën hyrë edhe në muajin shkurt në grevë. Ata po kërkojnë të rregullohet statusi ekonomiko-financiar për kontrollorët e trafikut ajror përmes amendamentimit të Ligjit të ASHNA-së ose përmes zbatimit të Marrëveshjes Kolektive Sektoriale (MKS).

Buxheti i Malishevës për vitin 2020 do të jetë mbi 15 milionë euro

MALISHEVË, 20 MAJ (ER) - Është mbajtur të hënën mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, e drejtuar nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në këtë mbledhje drejtori për Buxhet dhe Financa i ka njoftuar drejtorët komunalë me qarkoren e parë buxhetore për hartimin e buxhetit 2020-2022. Bazuar në këtë qarkore, buxheti për vitin 2020 pritet të jetë 8 për qind më lart se buxheti i këtij viti.

Gjatë raportimit të tij, në Këshillin e Drejtorëve, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, ka deklaruar se buxheti për vitin 2020 do të jetë për 8 për qind më i lartë se buxheti i vitit aktual apo 1.2 milion euro më shumë. "Buxheti për vitin 2020, sipas qarkores së dërguar, është 15 583 802 euro apo 1.2 milion më shumë se buxheti i këtij viti", ka deklaruar Mazreku. Po ashtu, ai ka kërkuar nga drej-

torët e drejtorive që t'i bëjnë planifikimet me kohë, edhe pse tashmë kanë filluar të punohet për hartimin e buxhetit. Në këtë mbledhje edhe drejtorët e drejtorive të tjera komunale kanë raportuar për aktivitetet e javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim. Drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, ka bërë me dije se më 25 maj do të mbahet testi i arritshmërisë për 37 shkollat e komunës sonë. Në



këtë kontekst, ai ka theksuar se për mbajtjen e testit Drejtoria e

Arsimit ka bërë të gjitha përgatitjet.

Çfarë pritet të nxjerrin zgjedhjet e paparashikueshme evropiane



Janusz BUGAJSKI

Zgjedhjet e ardhshme parlamentare të BE-së do të tregojnë se në cilin drejtim po shkon Evropa: Drejt ringjalljes apo ndarjes. Ato mund ta përforcojnë populizmin anti BE-së, t'i ringjallin partitë tradicionale pro BE-së, ose thjesht t'i përkeqësojnë konfliktet përkrasë. Për herë të parë në histori, zgjedhjet parlamentare të BE-së janë bërë arenë e emocioneve politike.

Votuesit nga çdo vend i BE-së do ta zgjedhin Parlamentin e ri Evropian më 23-26 maj, përfshirë këtu edhe Mbretërinë e Bashkuar pas shtyrjes shtatë-mujore të Brexitit. Parlamenti i BE-së, i përbërë nga 751 anëtarë, e që zgjidhet çdo pesë vjet, është institucioni i vetëm evropian përfaqësues i drejtpërdrejtë, edhe pse pjesëmarrja mesatare e votuesve në votimet e mëparshme mezi arrin në 43 për qind. Parlamenti ka

autoritetin që të ndryshojë, refuzojë ose miratojë legjislacionin që ndikon në jetën e të gjithë qytetarëve të BE. Ai gjithashtu voton për miratimin e 28 anëtarëve të Komisionit Evropian, pra qeverinë e BE-së. Që nga votimi pro-Brexit dhe suksesi i partive euroskeptike në disa shtete kanë rënë kampionat e alarmit se nacionalistët populistë do të dominojnë dhe paralizojnë parlamentin e ri. Liderët nacionalistë po inkurojnë qytetarët që të votojnë duke pretenduar se ata ofrojnë një "harmoni të re evropiane" që do të kufizonte pushtetin e organeve të BE dhe do të rivendoste sovranitetin e shtetit.

Kjo harmoni u prezantua në një miting në Pragë më 25 prill, të sponsorizuar nga Lëvizja për Evropën e Kombeve dhe Lirisë (MENF), një aleancë pan-evropiane e nëntë partive nacionaliste, që kërkon frenimin e emigracionit masiv dhe rikuperimin e sovranitetit kombëtar nga organet e BE. Në aleancë përfshihen Partia Çeke për Lirinë dhe Demokraci (SPD), Partia Holandeze e Lirisë (PVV), Fronti Nacional Francez (RN), Partia e Lirisë në Austri (FPO) dhe Partia Liga në Itali.

Nacionalistët i shohin zgjedhjet e majit si referendum për të ardhmen e BE-së. Matteo Salvini, Ministri i Brendshëm italian dhe kreu i Partisë "La Liga", u ka bërë thirrje partive nacionaliste të Parlamentit Evropian që të formojnë një aleancë të re, të cilën Marie Le Pen, lidere e Frontit Nacional e ka pagëzuar "Aleanca Evropiane e Kombeve". Salvini thirri një takim në Milano më 18 maj për partitë kryesore anti-BE, mes tyre Alternativa për Gjermaninë (AfD), Partia Popullore e Danimarkës (DF) dhe Partinë Finns (PS) dhe pret që ky bllok i ri të formojë koalicionin më të madh parlamentar.

Megjithatë, një përpjekje për të formuar një "ndërkombëtare nacionaliste" ka limitet e saj, sidomos mes fqinjëve me armiqësi historike, paragjykimet kulturore dhe ku mbizotërojnë interesat e dukshme kombëtare. Partitë nga vende të ndryshme mund të bien dakord me një platformë anti-emigracion, por jo të gjithë populistët kërkojnë të ndjekin Brexit. Ka përçarje mes ekstremistëve, që duan të shpërbëjnë plotësisht Unionin dhe euroskeptikëve që kërkojnë të kufizojnë favorët e zyrtarëve të

BE dhe t'u lënë më shumë vendime në dorë parlamenteve kombëtare.

Sondazhet e fundit tregojnë se evropianët nuk janë thjesht të ndarë mes pro-evropianëve dhe nacionalistëve, pasi ka shkallë të shumta në mes dhe shumë votues nuk kanë preferencë të ngurta. Kjo nuk do të thotë që partitë tradicionale do të tërhiqen nga zgjedhjet e BE-së, por populizmi ka kufijtë e tij. Që partitë e "zakonshme" të rifitojnë besimin e publikut, duhet të riformohen dhe të luftojnë për qytetarët e zakonshëm dhe stabilitetin kombëtar në një periudhë pasigurie të thellë publike. Një sërë zgjedhjesh presidenciale, kombëtare dhe vendore kanë treguar se elektorati mund të mos jetë polarizuar rrënjësisht, por është jashtëzakonisht i paqëndrueshëm. Përgjatë muajve të fundit shumëllojshmëria e partive politike në spektrin politik kanë pasur rezultate më të mira se ç'pritej, përfshirë Të Gjelbrit në Gjermani, social-liberalët në Sllovaki dhe ultra të djathtët në Spanjë. Një raport i fundit nga Këshilli Evropian për Marrëdhëniet me Jashtë (ECFR) zbuloi pothuajse 100 milionë votues të lëkundur pa përkatësi politike, para zgjedhjeve të BE-

së, që formojnë 70 për qind të qytetarëve që pohuan se po planifikojnë të votojnë.

Për më tepër, prioritetet e zgjedhësve ndryshojnë gjatë çdo cikli zgjedhor. Fokusi i mëparshëm mbi imigracionin masiv tani është zhvendosur drejt korrupsionit të qeverive, kujdesit shëndetësor, standardeve të jetesës, papunësisë së të rinjve dhe veçanërisht në Evropën Qendrore dhe Lindore emigrimin e profesionistëve të arsimuar.

Prurjet e reja të paparashikuara në politikë, të majtë, të djathtë dhe të qendrës, mund t'i bëjnë pesë vjetët e ardhshëm, ato më të paqëndrueshmet në historinë e BE-së, edhe pa dramën Brexit në dukje të pafund.

Zgjedhjet, gjithashtu, do të jenë subjekt i ndërhyrjes së shtetit rus për të ndikuar te votuesit. Moska po mobilizon rrjetin e gjerë të mediave, lajmet false, platformat sociale dhe mbështetësit e lidhur me mediat për ta promovuar radikalizmin, polarizimin, frikën dhe konfuzionin midis elektoratit të BE-së.

Kremlini nuk është i lidhur nga ideologjia, por inkurajon të gjitha ekstremet që t'i sulmojnë themelet e demokracisë evropiane.

(Marrë nga gazeta "Dita")

Gashi në Berlin: Kosova e përkushtuar për bashkëpunim rajonal në fushën e rinisë

BERLIN, 20 MAJ (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, po qëndron për një vizitë zyrtare në Gjermani. Në kuadër të kësaj vizite, Gashi në Berlin, në cilësinë e përfaqësuesit nga Kosova, është duke kryesuar Zyrën Regjionale për Bashkëpunim Rinor (RYCO) dhe po merr pjesë në konferencën "Bashkëpunimi rajonal parlamentar në mbështetje për angazhimin e RYCO-s dhe parlamenteve në procesin e Berlinit".

Në këtë konferencë po marrin pjesë deputetë dhe përfaqësues nga vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe nga Gjermania e Franca. Në të u diskutua për rëndësinë dhe rolin ndihmues të parlamenteve në procesin e Berlinit, respektivisht për ndihmën që parlamentet mund ta japin për rininë në përgjithësi dhe RYCO-n në veçanti.

Ministri Gashi potencoi se parlamentet dhe deputetët kanë rol të veçantë dhe domethënës sa i përket ndihmës dhe mbështetjes për të rinjtë, duke pasur parasysh ndikimin që ata mund ta luajnë te subjektet politike,



veçanërisht në parlamentet e tyre. "Arsyeja për të cilën ne jemi mbledhur këtu është jashtëzakonisht e rëndësishme jo vetëm për RYCO-n si mekanizëm që synon fuqizimin e bashkëpunimit rajonal, por për secilin prej nesh, pasi konsideroj se qëllimi ynë përballë këtij procesi është i njëjtë anë pse perspektiva mund të jetë e ndryshme", ka thënë ministri Gashi në fjalën e tij.

Ministri Gashi e vlerësoi rolin e parlamenteve dhe parlamentarëve si thelbësor, posaçërisht për krijimin e një mjedisi ku qytetarët e rajonit tonë, me theks të rinjtë, të jenë të gatshëm dhe në gjendje të bashkëpunojnë me njëri-tjetrit. "Si ligjvënës në nivel nacional ju keni fuqi për të bërë politika të cilat, po ashtu, në një formë apo tjetër implikojnë zhvillimet në nivelin rajonal. Prandaj, edhe

kontributi juaj është i një rëndësie të veçantë. Mbështetja juaj konkrete si ligjvënës për RYCO-n dhe të rinjtë e rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke e pasur parasysh faktin se RYCO dhe të rinjtë e rajonit po bashkëjetojnë në një mjedis të ndjeshëm socio-politik, është më se e nevojshme", ka porositur ministri Gashi.

Në fjalën e tij ministri Gashi po ashtu u bëri thirrje deputetëve

pjesëmarrës në konferencë që të bashkohen drejt kauzës që tërë Ballkanin Perëndimor ta bëjnë një rajon më të mirë për të gjithë duke e mbështetur RYCO-n dhe të rinjtë me vendime të duhura politike dhe mënyra të tjera. "Mbështetja e vazhdueshme financiare dhe jofinanciare edhe nga partnerët e tjerë do të jetë e nevojshme në vazhdimësi andaj përkrahja e partnerëve si Franca dhe Gjermania mbetet e domosdoshme për një rritje të qëndrueshme të RYCO-s", ka thënë ministri në fund të fjalës së tij si kryesues i Bordit Drejtues të RYCO-s, me ç'rast edhe ka falënderuar Parlamentin Gjerman për fondin e alokuar te RYCO për mbështetje të shkëmbimeve të shkollave në rajon, por edhe Qeverinë e Francës për mbështetjen e RYCO-s.

Ministri Gashi ka porositur edhe të rinjtë që të jenë ambiciozë dhe këmbëngulës në kërkesat e tyre duke i sfiduar vendimarrësit e politikëbërës në limite. "Unë besoj në sloganin e RYCO-s, që një rajon më i mirë fillon me të rinjtë, andaj është radha juaj", ka thënë Gashi.

Formimi dhe veprimtaria e organizatës patriotike ilegale 'Fronti Nacional Çlirimtar i Kosovës' (FNÇK) 1982



**Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA**

Më 19 qershor 1984 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë para trupit gjykues të të pestëve, kryesuar nga gjykatësi Ahmet Ahmeti, filloi gjykimi i pjesëmarrësve të organizatës ilegale "Fronti Nacional Çlirimtar", të cilin e përbënin 20 ilegalistë. Me këtë shkrim i njoftonte lexuesit e vet gazeta "Rilindja" e 20 qershorit 1984. Në bankën e zezë të gjykatës u ulën:

1. Sejdi Veseli (1949), Orllan (Podujevë), teknik shëndetësor (14 vjet burg)
2. Rrahman Bahtiri (1954), Brainë (Podujevë), punëtor (3 vjet burg)
3. Shemsi Veseli (1961), Orllan (Podujevë), student (11 vjet burg)
4. Esat Brajshori (1963), Sharban (Podujevë), student (11 vjet burg)
5. Musli Prebreza (1962), Vranidoll (Podujevë), teknik m. (10 vjet burg)
6. Hamdi Rafuna (1958), Gjyrishevc (Kamenicë), teknik medicinal (9 vjet burg)
7. Sabri Sopa (1963), Mramor (Prishtinë), sh. m. (10 vjet burg)
8. Fatmir Sopa, (1961), Mramor (Prishtinë), student (7 vjet burg)
9. Agim Sahiti (1956), Kishnapole (Gjilan), teknik i makinerisë (8 vjet burg)
10. Islam Krasniqi (1956), Majanc (Podujevë), sh. m. t. (6 vjet burg)
11. Tefik Ramadani (1954), Qarr (Bujanoc), defektolog (6 vjet burg)
12. Muhamet Kryeziu (1956), Dushanovë (Prizren), p. i farmacistë (3 vjet burg)
13. Skender Boshnjaku (1948), Vushtrri, epidemiolog i dip. (4 vjet burg)
14. Ilaz Zhitia (1962), Llugë (Podujevë), sh. m. elektro (10 vjet burg)
15. Ramadan Avdiu (1964), Prishtinë, student (8 vjet burg)
16. Sali Sefa (1958), Prapashiticë, teknik medic. (8 vjet burg)
17. Afrim Zhitia (1965), Llugë (Podujevë), student (8 vjet burg)
18. Xhemajl Rexhepi (1958), Prishtinë, teknik i elek. (7 vjet burg)
19. Kadri Haziri (1954), Bellopojë (Podujevë), makinist (3 vjet burg)
20. Rexhep Makolli (1955), Prishtinë, metalgdhendës (3 vjet burg).

Në fund të vitit 1979 Sejdi Veseli, në kontakt me Agim Salihun, në Prishtinë kanë folur për padrejtësitë e shumta që u bëheshin shqiptarëve, për diskriminimin e tyre nga ana e pushtetit dhe okupatorit serbosllav në

Kosovë. Më vonë bien në kontakt me Nexhat Qehan, i cili ua jep për lexim revistën ilegale "Bashkimi", organ i organizatës ilegale "Fronti i Kuq Popullor", ndërsa në fillim të vitit 1980 nga Agim Sahiti marrin librat ilegalë, si: "Vetadministrimi jugosllav, teori dhe praktikë kapitaliste", "Imperializmi dhe revolucioni" dhe "Hrushovianët".

Në tetor të vitit 1980, në kontakt me Agim Sahitin, në shtëpinë e tij, u pajtuan që ta vazhdonin aktivitetin ilegal kundër pushtetit dhe okupimit serb në Kosovë. Marrin qëndrim që t'i gjejnë shokët më besnikë për ta vazhduar aktivitetin ilegal. Merren vesh që të formojnë një celulë e cila do të merrej me veprimtari ilegale. Me qëllim të formimit të këtij



Grupi i Sejdi Veselit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, më 19 qershor 1984

grupi Sejdi Veseli kontakton me Rrahman Bahtirin, Musli Prebrezën, Hamdi Rafunën, Sali Sefën dhe Hazbi Bunjakun, me të cilët bisedon dhe nxjerrin përfundim se duhet të merren vazhdimisht me veprimtari ilegale. Më 15 nëntor 1980, në takim në shtëpinë e Rrahman Bahtirit në Prishtinë, Sejdi Veseli, në praninë e Rrahman Bahtirit, Agim Sahitit, Islam Krasniqit, flet për formimin e një organizate ilegale kundër RSFJ-së, me kërkesë për fitimin e të drejtave të plota kombëtare dhe sociale, pasi që më parë ka folur për kufizimin e të drejtave kombëtare, pabarazinë e kombit shqiptar me kombet e kombësitë e tjera në Jugosllavi, për papunësinë, për ngecjen e Kosovës në krashim me vendet e tjera. Ndër të tjera, ka propozuar që të formohet organizata ilegale dhe të pagëzohet me emrin "Fronti i Çlirimit Kombëtar" dhe ka shprehur nevojën që secili prej tyre të bëjë përpjekje për të angazhuar njerëz me qëllim të masivizimit të kësaj organizate. Në vazhden e kësaj detyre Sejdi Veseli takohet me Musli Prebrezën, Sali Sefën dhe Hamdi Rafunën, të cilët i anëtarëson në "FÇK". Më vonë kontakton edhe me Tefik Ramadanin, me të cilin zhvillon bisedë të ngjashme si me të tjerët që kishte biseduar

më herët.

Gjatë vitit 1981 mbante kontakte të vazhdueshme me personat të cilët i konsideronte anëtarë të "FÇK"-së. Nga anëtarët e grupit kishte edhe mendime se organizata duhej të vazhdonte edhe me aksione konkrete, siç ishte "akti i diversionit", me qëllim të kryerjes së veprimeve terroriste". Por, udhëheqësi i grupit këto propozime nuk i pranon. Mirëpo, duke vazhduar më tej, shton se po qe se nuk realizohet statusi i Kosovës - Republikë pjesëtarët e organizatës së tij do të ngrihen në luftë të armatosur.

Në aktakuzën PP. nr. 60/84, thuhej se më 17 shkurt 1982, në Prishtinë, në lokalet e Shkollës Fillore "Zenel Hajdini", me anë-

mbi 90 anëtarë dhe interesimi i individëve për t'u futur në radhët e saj ishte i madh.

Për ngritje ideopolitike udhëheqësi i grupit siguronte literaturë të llojllojshme nga kanalet e ndryshme që hynin në Kosovë. Për anëtarët e vet siguroi periodikun ilegal, si: "Zëri i Kosovës", "Informatat", si dhe një mori librash. Përveç këtij aktiviteti, anëtarët angazhohen që të shpërndajnë afishe të ndryshme dhe të shkruajnë e të përpilojnë tekste me përmbajtje armiqësore. Para trupit gjykues Sejdi Veseli tërë veprimtarinë e vet ilegale e pranon dhe shpjegon se si ka tentuar që të shkojë në ambasadën e Shqipërisë në Bullgari (Sofje) që me personelin e saj të bisedojë për qëllimet humane të "FNÇ"-së. Nuk e ndien veten fajtor. Të gjitha veprimet i ka bërë ngase ka qenë i vetëdijshëm për një punë të tillë.

Në foltoren e gjykatës Rrahman Bahtiri tha se të gjitha veprimet të drejtuara kundër sistemit dhe Jugosllavisë i ka bërë me vetëdije dhe për to nuk pendohet aspak. Përshtypje të madhe te të pranishmit la fjala e tij, e sidomos gazetarët shqiptarë e quajtën me ironi se ai mbajti "një ligjëratë" të madhe historike, duke u ndalur në tri faza. Bëri fjalë për vitin 1948, atë 1956 dhe në fund për vitin 1965. Veç të tjerash, tha: "Shqiptarët vazhdimisht kanë qenë të shtypur nga serbomëdhenjtë", por gjyqtari ia tërhoqi vërejtjen se duhej të përgjigjej për atë që ishte i ftuar.

Atëherë ai kërkoi nga gjykata që t'i sqarohet rasti i vrasjes së vëllait - Bajramit, pas mbajtjes së burgut" ose ndryshe nuk do ta paraqesë mbrojtjen. Trupi i gjyqtarëve i premtoi se për këtë do të njoftohet nga prindërit e vet për çdo gjë. Rrahmani pranoi se ai ishte personi që kishte shtruar nevojën për formimin e "FNÇ"-së, në takimin që pati me Sejdi Veselin më 15 nëntor 1980. Në mbledhjen themeluese më 17 shkurt 1982, që u mbajt në lokalet e Shkollës Fillore "Zenel Hajdini" zgjidhet anëtar i "Komitetit të FNÇ"-së dhe njëherësh merr funksionin e sekretarit ekzekutiv. Në këtë tubim miratohen "Programi" dhe "Statuti" i organizatës ilegale. Veç faktit se ishte anëtar i kësaj organizate, Rrahmani pranoi se ka dhënë betimin solemn në praninë e anëtarëve të tjerë. Procedura e betimit është kryer në këtë mënyrë: në praninë e anëtarëve dhe para Sejdi Veselit, ai ka lexuar tekstin e betimit, ndërsa anëtar i ri që është pranuar ka përsëritur fjalët pas tij, me qëndrim gatitu. Në solemnitet kanë pasur edhe flamurin kombëtar dhe me grushtin lart bëheshin anëtarë të organizatës.

Në qershor të vitit 1983 kishte kontaktuar me Sabri Sopin. Së



Shemsi Veseli




**Rrahman Bahtiri
1954-2010**

bashku me Sejdi Veselin, Musli Prebrezën, vëllamë e tij Bajramin dhe Esat Bicin kanë shkruar në fshatin Zallash, që t'i fshehin materialet ilegale, mjetet teknike, po edhe persona të tjerë të arratisur. Po ashtu janë marrë vesh që Sabriu dhe Fatmiri të ndërtonin një bunker me madhësi 2 me 3 metra. Gjatë korrikut të vitit 1983 Sabriu dhe Fatmiri i jep materiale ilegale, siç ishin revista "Zëri i Kosovës", "Informatat" e "GMLK"-së, afishja me titull "Letra" dhe materiale të tjera. Gjatë tërë kohës ka vepruar me emrin konspirativ "Shpendi". Anëtar i tretë i organizatës "FNÇ" ishte vëllai i Sejdi Veselit, Shemsi Veseli. Anëtar i organizatës bëhet në shtator të vitit 1982. Gjatë kësaj periudhe intensivisht lexon shtypin ilegal të kohës. Ai gjatë procedurës së pranimit në radhët e "FNÇ"-së e merr pseudonimin "Rrufeja" dhe bëhet anëtar i "Komitetit". Shpërndan traktin të vullosur me vullën e organizatës. Në radhët e "FNÇ"-së angazhon Xhevat Halilin dhe Ramadan Avdiun. Shemsi Veseli, sipas direktivave që i kishte nga udhëheqësi, për formimin e "komiteteve të vendeve", gjatë dhjetorit të vitit 1983 merr detyrën e delegatit dhe ndihmësdelegatit për Obiliq e Suharekë. Po ashtu, nga i vëllai mëson se është bërë riorganizimi në Shtabin Operativo-Shkencor, ku merr postin e zëvendëskomisarit politik. "Komiteti Rajonal" i "Shtabit Operativo-Qarkor" dhe "Komiteti i vendit" i "Shtabit Operativo-Rajonal" i miratojnë këto ndryshime. (Vijon)

E jashtëzakonshme

Hakeri 13-vjeçar që vodhi pasvordet e 35 mijë përdoruesve, bëhet konsulent banke

Një djalë 13-vjeçar norvegjez kishte arritur t'i vidhte pasvordet e 35 mijë përdoruesve dhe është quajtur djali magjistar nga një prej bankave më të njohura digjitale në qytetin e tij Bergen në Norvegji, raportojnë mediat norvegjeze. Pasvordet dhe informacionet digjitale që djali kishte arritur t'i hackeronte iu përkisnin profesorëve, studentëve të shkollave private dhe



lokaleve. Më pas erdhi edhe oferta e punës nga një ndër bankat më të njohura online. Djaloshi është punësuar për muajt e verës si konsulent i angazhuar për ta rikontrulluar sistemin e sigurisë.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Shoku polic, kam një problem. Më ndjekin më shumë se 500 mijë persona.
Polici: Ku ndodhjeni?
Djali: Në "Facebook".




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min



Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton

FOTO E DITES



Palestinezët shihen duke ngrënë iftar pranë rrënojave të një ndërtese të shkatërruar kohët e fundit nga sulmet ajrore izraelite në qytetin e Gazës. (Reuters/VOA)

Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min



Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo

Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min



Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger

E rrallë

Gjen copëzën e arit me vlerë 69 000 dollarë

Një australian ka zbuluar një copëz ari prej 1.4 kilogramësh me anë të një detektori metali në Western Australia. Një dyqan në Kalgoorlie ka publikuar fotografitë e arit online dhe besohet të ketë një vlerë 69 000 dollarë. Gjetje të tilla ndodhin disa herë në vit, thonë ekspertët. Rreth 3/4 e



minierave të arit në Australi ndodhen rreth rajonit Kalgoorlie.

16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi



Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Po fokusoheni në gjëra komplet të parëndësishme kur ndërkohë janë të tjera prioritetet tuaja për ditën e sotme.</p>	 <p>DEMI Mund t'i lini të tjerët t'i japin përshtypjet e tyre për atë që po bëni, por pa anashkaluar faktin që në fund të ditës jeni ju që do të vendosni.</p>	 <p>BINJAKËT Koha që keni në dispozicion nuk ju mjafton për t'u dhënë zgjidhje problemeve që ju lindin. Do të kërkonin ndihmë te personat e afërt.</p>	 <p>GAFORRJA Keni qenë pak neglizhent ditët e fundit dhe keni lejuar që dikush ta keqkuptojë sjelljen tuaj. Do të jetë vonë për ta rikuperuar sot.</p>	 <p>LUANI Një vendim që duhet ta merrni bashkë me partnerin do t'ju fusë në debate të mëdha. Ju tashmë keni vendosur pa pyetur gjysmën tuaj.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Personat që po ju vëzhgojnë nga ana profesionale kanë disa rezerva sa i përket përshtatjes suaj me ambientin e punës.</p>
 <p>PESHORJA Duhet të keni pak më tepër bonsens sot për të kuptuar situatën e caktuar që dashur padashur do t'ju bëjnë të mërziteni.</p>	 <p>AKREPI Jeta juaj private ka nevojë për disa pika fikse reference. Në këto çaste nuk keni pse tregoheni konfuz me atë që ju përket më shumë.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse evitoni të dëgjoni biseda që nuk kanë të bëjnë me thelbin e gjërave sot, do t'i hiqni vetes një barrë të mërzitshme që nuk keni pse ta kaloni.</p>	 <p>BRICJAPI Nëse flisni pak dhe dëgjoni më shumë do të arrini të dalloni ato çështje dhe situata që janë vërtet të rëndësishme për ju.</p>	 <p>UJORI Duhet të filloni të mendoni në mënyrë pozitive për çdo gjë që ndodh rrotull jush. Vetëm kështu do të arrini t'i shikoni më qartë gjërat.</p>	 <p>PESHQIT Sigurisht se dhe ju keni bërë kompromisimet tuaja në të shquarën. Për këtë arsye jeni duke u treguar shumë të vëmendshëm tani.</p>

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Ramaj: Duam suksese edhe në Evropë

Triumfi në kampionat dhe kualifikimi në finale të Kupës e kanë "trimëruar" shumë kryetarin e KF Feronikeli, Naser Ramajn, i cili tash po kërkon suksese edhe në garat ndërkombëtare. "Nuk do të ndalem që Feronikeli ta tejkalojë famën nacionale edhe në skenën ndërkombëtare. Për këtë, jemi gati të gjithë, sepse ne mundemi dhe duam, për Feronikelin tonë, sportin e sportdashësit tonë, Drenasin dhe Kosovën tonë", ka thënë Ramaj

**EPOKA ERE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 20 MAJ - Kryetari i KF Feronikeli, Naser Ramaj, ka thënë se skuadra nga Drenasi me meritë është shpallur kampione e IPKO Superligës në futboll. Ai ka uruar futbollistë, trajnerë, qytetarë të Drenasit dhe Drenicës, në veçanti tifozët "Tigrat e Zi". "U rikonfirmua edhe një herë pse jemi kampionë. Fitorja ballë për ballë, me pretendentin për titullin kampion, e vulosi punën tonë njëvjeçare. Sporti me shpirt garues, fitoi. Fitoi besimi i futbollistëve tanë, prej xhiros së parë, se do të rikthehem kampionë në krye të tabelës. Shumë punuam që ta arrijmë këtë. Faleminderit nga zemra të gjithë kontribuuesve për këtë titull. Qytetarët e Drenasit e kanë merituar këtë titull të kampionit sepse vërtet jemi më të mirët", ka thënë Ramaj, i cili më pas ka treguar edhe se si erdhi që ai ta marrë drejtimin e skuadrës së Feronikelit.

Ramaj tregoi se si sporti ishte një fushë e panjohur për të, por nga dëshira për ta ndihmuar komunën e tij, Drenasi vendosi të kontribuojë në sport. "Kjo ditë nuk ishte aq e shpejtë për të qenë kampionë. Megjithatë, ishte ditë që u nis, nga vullneti i mirë, gjithsesi nga dashuria ime për komunën time, për të rinjtë tanë dhe për sfida: Çfarë po bëj për vendin tim. Sporti nuk ishte hapësirë e njohur për mua, por për mua ishte e njohur komuna ime dhe

qytetarët e saj që dy herë kishin qenë kampionë nacionalë dhe disi lëkundej besimi në Klubin e Feronikelit. Sfida tashmë kishte marrë udhë pas takimit me kryetarin e komunës së Drenasit, z. Lladrovci, edhe pse sporti nuk ishte lëmë imi profesional apo synim apo shqetësim ditor. Megjithatë, unë besoj, prandaj erdha në krye të klubit, me përkushtimin dhe qëndrueshmërinë e një fushe krejt tjetër, në fushë të futbollit", ka shtuar ai. Numri një i skuadrës nga Drenasi dëshiron që skuadra e Feronikelit të lërë gjurmë edhe në arenën ndërkombëtare. "Nuk do të ndalem që Feronikeli ta tejkalojë famën kombëtare, po të njihet edhe në skenën ndërkombëtare. Për këtë jemi gati të gjithë, sepse ne mundemi dhe duam, për Feronikelin tonë, sportin e sportdashësit tonë, Drenasin dhe Kosovën tonë", ka deklaruar Ramaj.

Titulli pasuron Feronikelin

Feronikeli është kampioni i ri në futboll dhe skuadra që do ta përfaqësojë Kosovën në Ligën e Kampionëve. "Nikli" do të pasurohet shumë financiarisht. Si kampioni i Kosovës, Feronikeli do të marrë nga UEFA 260 mijë euro. Vetëm pjesëmarrja në rrethin paraeliminuar të Ligës së Kampionëve, Feronikelin do ta pasurojë me 230 mijë euro të tjera. Në rast se Feronikeli do ta kalojë rrethin para kualifikues dhe luan në rrethin e parë në Ligën

e Kampionëve, atëherë do të përfitojë edhe 280 mijë euro të tjera. Por nëse Feronikeli nuk e fiton rrethin para kualifikues do të luajë në raundin e dytë në Ligën e Evropës dhe këtu do të fitonte 260 mijë euro. Pra, në total, Feronikeli do të fitojë minimum 770 mijë euro nëse e kalon turin para kualifikues, por në rast se nuk e kalon, do të fitojë 750 mijë euro. Këto shifra mund të rriten edhe më shumë, varësisht nga sukseset e "Niklit" në garat evropiane.

'Nikli' mëson kundërshtarët në Ligën e Kampionëve

Skuadra e Feronikelit, pasi fitoi titullin e kampionit në Kosovë, do të marrë pjesë në parakualifikueset e Ligës së Kampionëve. Kjo fazë do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, që do të jetë një ndihmesë e madhe për ekipin e Zekirija Ramadanit. Momentalisht, kampioni i ri i Kosovës është njoftuar me dy kundërshtarët e mundshëm dhe është në pritje të kundërshtarit të tretë, pasi në këtë fazë marrin pjesë katër ekipe nga kampionatet që kanë koeficientet më të ulët. Santa Colomna si kampion i Andorrës dhe Lincoln Red si kampion i Gjibraltarit, bashkë me Feronikelin, do të jenë pjesë e kësaj faze. Ekipi i katërt do të jetë nga San Marino, La Fiorita ose Tre Penne. Ndashjet do të zhvillohen në Prishtinë nga 20 deri më 27 qershor.

SHKURT

Kosova, dy miqësore me Shqipërinë

Përfaqësuesja e U19 e Kosovës në futboll muajin e ardhshëm do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore me Kombëtaren U19 të Shqipërisë. Të dy këto miqësore do të zhvillohen në Kosovë më 3 dhe 5 qershor dhe do t'i shërbejnë përzgjedhësit Ramiz Krasniqi për t'u përgatitur sa më mirë për kualifikimet e Kampionatit Evropian. Grumbullimi i Përfaqësues U19 do të bëhet më 1 qershor në hotel "Venus" në orën 12:00, kurse për këtë ndeshje përzgjedhësi Krasniqi ka ftuar 23 futbollistë.

Hyrja falas në finalen Kosova (P) - Mitrovica

Të mërkurën, më 22 maj, nga ora 19:00, në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë do të zhvillohet ndeshja finale e Kupës së Kosovës në konkurrencën e femrave ndërmjet Kosovës (P) dhe Mitrovicës. FFK-ja njofton të gjithë dashamirët e futbollit se hyrja në këtë ndeshje është falas dhe fton ata që të jenë të pranishëm në këtë ndeshje për t'i dhënë përkrahje futbollit të femrave dhe për ta bërë sa më madhështore këtë ndeshje.

Roma rikthen Tottin

Largimi i Daniele De Rossit ka sjellë acarimin e tifozëve të Romës. Ofendimet për presidentin Palota nuk kanë fund, ndërsa atmosfera është shumë e keqe. Për ta qetësuar sadopak revoltën e tyre, kreu i klubit ka marrë një vendim. Ai ka zgjedhur Francesco Tottin drejtor të ri teknik. Post i rëndësishëm për legjendën verdhekuqe, i cili do të jetë ura lidhëse e klubit me trajnerin dhe do të ketë ndikim në vendimmarrje dhe transferime. Nga ana tjetër është edhe trajneri. Kandidat kryesor mbetet Gasperini, por Atalanta është me një këmbë në Ligën e Kampionëve dhe ai mund të qëndrojë në Bergamo. Roma ka gati dy alternativa të tjera: Mauricio Sarrin dhe Marcelo Bielsën.

City 'blindon' Guardiolen

MANCHESTER, 20 MAJ - Skuadra e Juventusit merr një tjetër goditje të fortë sa iu përket pretendimeve për ta sjellë në Torino Pep Guardiolen si zëvendësues për Massimiliano Allegrin. Manchester City ka arritur pajtimin me trajnerin katalanas për rinovimin e kontratës së tij edhe për pesë vjet të tjera, e kjo ndodh vetëm pak ditë pasi

vetë Guardiola deklaroi qëndrimin të "Citizens". Lajmi bëhet me dije nga tabloidi britanik "The Sun", sipas të cilit, klubi kampion i Premierë Ligës është gati ta mbulojë në ar 48-vjeçar, teksa i ka përgatitur një kontratë prej 115 milionë eurosh, që do të thotë se Guardiola do të përfitojë një pagë prej 22 milionë eurosh në sezon. Shifër kjo,

5 milionë euro më e lartë sesa paga aktuale e tij. E gjitha kjo ndodh kur për Manchester Cityn ekziston rreziku i përjashtimit nga Liga e Kampionëve sezonin e ardhshëm, nga UEFA. Por, duket se drejtuesit e kampionëve të Anglisë nuk janë shumë të shqetësuar për këtë fakt përderisa vendosën ta mbajnë Pep Guardiolen në bankinë.



Konfirmohen tre boksierë të Kosovës në 'Minsk 2019'



PRISHTINË, 20 MAJ - Ka shkuar në 12 numri i sportistëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat e dyta Evropiane "Minsk 2019" që mbahen prej 21-30 qershorit në kryeqytetin e Bjellorusisë. Sot janë konfirmuar edhe tre boksierë: Shpëtim Bajoku, kategoria deri në 64 kilogramë, Patriot Behrami (-69 kg) dhe Ardit Delijaj (-81 kg). Konfirmimi për boksierët ka ardhur pasi Unioni Evropian i Boksit (EUBC) ka vendosur që garat e boksit në "Minsk 2019" të vlejnjë si kampionat evropian, njësoj si disa sporte të tjera. Nga sporti i boksit është edhe Donjeta Sadiku, e konfirmuar muaj më parë

me ftesë. Më së shumti sportistë nga Kosova në Minsk do të ketë xhudoja, gjithsej pesë: Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Distria Krasniqi, Loriana Kuka e Akil Gjakova, të cilët janë kualifikuar me normë, ndërsa me ftesë janë edhe Alvin Karaqi (karate), Fatih Karabaxhaku (pingpong) dhe Ardita Zejnullahu (shigjetari). Dy normat e konfirmuara nga organizatori për sportin e mundjes nuk do të marrin pjesë pasi Drilon Sylja është i lënduar, ndërsa Egzon Shala nuk është lejuar nga Federata Evropiane e Mundjes, pasi më parë ka përfaqësuar Shqipërinë. Kosova synon të kthehet me medalje, pas të

LISTA E SPORTISTËVE

Majlinda Kelmendi	(xhudo)
Nora Gjakova	(xhudo)
Distria Krasniqi	(xhudo)
Loriana Kuka	(xhudo)
Akil Gjakova	(xhudo)
Alvin Karaqi	(karate)
Fatih Karabaxhaku	(pingpong)
Ardita Zejnullahu	(shigjetari)
Donjeta Sadiku	(boks)
Shpëtim Bajoku	(boks)
Patriot Behrami	(boks)
Ardit Delijaj	(boks)

bronzës të fituar në Lojërat Evropiane "Baku 2015", me xhuditën Nora Gjakova.

